



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.379/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, (QNR)-Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për parregullsi gjatë numërimit të votave me kusht në QNR-KQZ, Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa rregullt ankesa Anr. 379/2019, e datës 29.10.2019, e parashtuar nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me të cilën ka kërkuar të eliminohen parregullsitë me rastin e numërimit të votave nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor - Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, për shkak të dallimeve në rezultat në mes të atyre të publikuara nga KQZ-ja dhe atyre në gazetën Bota Sot.

A r s y e t i m

Me datën 26.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.379/2019, të parashtuar nga PLE në të cilën thekson se në QNR-KQZ në ora 23:03 kanë figuruar 324 vota për PLE ndërsa më vonë në ora 01:10 ka ndryshuar rezultati nga 324 vota janë shënuar 284 vota për subjektin e tyre PLE. Subjekti politik PLE pretendon në tabelën zyrtare të KQZ-së në internet ashtu siç shihet edhe në foton e bashkangjitur ankesës, subjekteve tjera politike ju rriten votat kurse subjektit politik PLE, iu zvogëlohen numrat e votave. Subjekti politik PLE pretendon se ky fakt mbështetet në fotot e bashkangjitura dhe konstaton se në rastin konkret, dyshojnë se ka pasur manipulim të votave me kusht dhe si viktimë e kësaj është subjekti politik PLE, ku këtij subjekti politik PLE iu kanë zvogëluar votat pa dhënë sqarime nga asnjë zyrtar i QNR-së paraqet shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, neni 105 si dhe mungesë të transparencës. Në mbështetje të pretendimeve të tyre ky subjekt si dëshmi ka bashkangjitur njëzënj nga gazetata zyrtare Bota Sot dhe faktin tjetër, tabelën zyrtare të KQZ-së.

Subjekti politik PLE kërkon nga PZAP-i që të trajtohet ankesa e tyre dhe ata si subjekt do ti ndjekin të gjitha rrugët ligjore, siç thekson me qëllim që i tërë procesi zgjedhor, përfshirë edhe numërimin e votave me kusht, të jetë i drejtë, i rregullt dhe demokratik.

Paneli, me rastin e ekzaminimit të ankesës, ka ardhur në përfundim se njëjta është e pa qartë si në aspektin e kërkesës kryesore e po ashtu edhe në aspektin e identifikimit të vendvotimeve, në paralajmërimi se nëse ankesa nuk përmirësohet e njëjta do të konsiderohet e tërhequr, ndërsa nëse kthehet e pa përmirësuar do të Hudhet poshtë.

Në përgjigjen e dorëzuar si plotësim të ankesës paraqitësi i ankesës thekson se PZAP-i se vendvotimi është e pamundur të dihet lidhur me rastin në fjalë por pretendojnë se rënia e votave të tyre është bërë gjatë numërimit të votave me kusht, sipas tyre në tavolinën numër 15 në QNR. Ndërsa në vazhdim thekson se PLE, beson fuqishëm në vënien e të drejtë së tyre dhe në pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të votave , si shprehje e vullnetit të votuesve të tyre. Subjekti politik PLE thekson se do ti ndjek të gjitha rrugët ligjore dhe pretendon se janë dëmtuar jashtëzakonisht shumë si subjekt politik dhe për këtë problematik nuk ka pranuar asnjë informatë zyrtare nga QNR, lidhur me sqarimin e kësaj problematike e cila do të kontribonte në dhënien e rezultateve në mënyrë sa më të drejtë dhe transparente.

Paneli me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës: ankesës, përgjigjes në ankesës dhe provave të dorëzuara, vlerësoi se:

Ankesa hudhet e pa rregullt

Nga shkresat e lëndës paneli vlerëson se subjekti politik PLE, me datë me datë 26.10.2019, ka paraqitur ankesë e cila i referohet procedurës së numërimit të votave, ku pretendon se me rastin e numërimit kësaj partie i janë zvogëluar votat dhe se për këtë është informuar nga gazeta ditore Bota Sot, ku rezultatet në këtë gazetë dhe në tabelën e rezultateve të KQZ-së kanë dallime.

Nga përgjigjeje apo plotësimi i pretenduar i ankesës paraqitësi i ankesës, deklaroi se është i pamundur të identifikohet në cilin vendvotim kanë ndodh parregullsitë por me hamendje thotë se ka mundur qenë tavolina nr.15 në QNR.

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoi se ankesa e paraqitur nga subjekti politik PLE , është e parregullt, sepse ankesa në fjalë nuk është e plotësuar edhe pas kërkesës nga PZAP-i për plotësim, nuk janë identifikuar vendvotimet lidhur me parregullsitë gjatë numërimit në QNR, për votat e subjektit në fjalë, dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kriteret ashtu siç parashihet me nenin 5.7 dhe nenin 6.3 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, *“Do të konsiderohet si e tërhequr ankesa po që se nuk i kthehet PZAP-it, brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pakorrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, ankesa do të hidhet poshtë”*.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekura.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 6.3 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.379/2019 më datën 29.10.2019

Kryesues i Panelit
Faton Ademi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.